



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1937/2 prot

Datë 17.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME.**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*INCOMED*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-03258-05-02-2024, me objekt: “Lot3 Fentanyl”, me fond limit 19,194,616.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 03-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Evita” SHPK me NIPT L31714005J dhe adresë Rruga Sami Frashëri, nr. Pasurie 7/120-N1, Zona kadastrale 8270, vol 28, faqe 155, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Rruga e Kavajës Nr.1001, Tirana, Albania
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “*INCOMED*” SHPK me NIPT K91530017T dhe adresë SH56, Vaqarr

Në datën 15.07.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1937/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4327 e operatorit ekonomik “*Evita*” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-03258-05-02-2024 me objekt “*Lot3 Fentanyl*” me fond limit:

19194616.0 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*INCOMED*” SHPK.

Bazuar në gjurmën “c”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriterin për të cilin operatori ekonomik ankimues “*E v i t a*” shpk në ankesën me nr. 1937/2024 prot., datë 16.07.2024, dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4327 pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “*INCOMED*” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “*INCOMED*” SHPK të kriterit si më poshtë vijon:

*“[...]Rezulton se oferta e paraqitur nga OE Incomed është anomalisht e ulët në zbatim të nenit 82, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar[...].”*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 17.07.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**